



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 244 , datë 18.3.2015

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, "PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES
KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR BASHKËPUNIMIN NË NXITJEN DHE LEHTËSIMIN E TREGTISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, "Për zbatimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

ARBEN AHMETAJ

**PROTOKOLL
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**“PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËPUNIMIN NË NXITJEN DHE
LEHTËSIMIN E TREGTISË”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, më poshtë të quajtura “Palët”,

Të udhëhequr nga dëshira për të lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë, nënshkruar në datën 11 janar 2014,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1
Harmonizimi i punës në fushën e rregullave teknike”**

Në përputhje me nenin 2, pika 1 (a) të Marrëveshjes, duke njohur rëndësinë që ka harmonizimi i rregullave teknike në rritjen e tregtisë dypalëshe, Palët synojnë unifikimin e rregullave teknike në produktet me interes reciprok nëpërmjet:

1. Përcaktimit të listës së produkteve industriale me interes reciprok, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Protokoll, me qëllim harmonizimin, njohjen reciproke, ose referimin në rregullat ose standardet ndërkombëtare sipas rastit;
2. Identifikimit të legjislacionit sektorial dhe Direktivat/Rregullat teknike të Bashkimit Evropian për produktet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Protokoll;
3. Hartimit të planit të përbashkët të ndryshimeve ligjore, brenda datës 30 Korrik 2015;

**Neni 2
Harmonizimi i punës në fushën e standardizimit**

Në përputhje me nenin 2, pika 1 (a) të Marrëveshjes, duke njohur rëndësinë që kanë standardet në rritjen e flukseve tregtare, Palët synojnë unifikimin e standardeve të zbatuara në të dyja vendet dhe rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve në të dyja vendet për zbatimin e standardeve të unifikuara, nëpërmjet:

1. Ndryshimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë për Standardizim të Kosovës brenda datës 30 Korrik 2015;
2. Rishikimit të çmimit për shitjen e standardeve deri në 50% të çmimit të deklaruar të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimeve;

3. Përshtatjes së standardeve me objektiv harmonizimin, njohjen reciproke, ose referimin në standardet ndërkombëtare sipas rastit;

Neni 3

Funksionet e Grupeve të Përbashkëta të Punës për eliminimin e barrierave tregtare të panevojshme

1. Në përputhje me nenin 6 të Marrëveshjes, duke njohur rëndësinë që ka eliminimi i barrierave tregtare të panevojshme në tregtinë midis dy vendeve dhe domosdoshmërinë për uljen e kostove të panevojshme të biznesit, Palët synojnë një eliminim sistematik të barrierave tregtare.
2. Funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Grupeve të Përbashkëta të Punës sipas pikës 1 të këtij neni, janë sipas Aneksve 1, 2 dhe 3.
3. Aneksset 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij protokollit janë pjesë integrale e tij.

Neni 4

Harmonizimi i punës në fushën e akreditimit

Në përputhje me nenin 2, pika 1 (d) të Marrëveshjes, duke njohur rëndësinë që ka fusha e akreditimit në rritjen e tregtisë dypalëshe, Palët synojnë reduktimin e pengesave të panevojshme, nëpërmjet:

1. Përshtatjes së skemave të akreditimit të laboratorëve testues, organizmave certifikues të produkteve dhe organizmave inspektues, me objektiv harmonizimin e tyre, duke ju referuar standardeve ndërkombëtare përkatëse;
2. Harmonizimit të legjislacionit për akreditimin e të dyja palëve me qëllim plotësimin e kërkesave të Regullores 765/2008 të Bashkimit Evropian;
3. Shkëmbimit të informacionit në lidhje me gjetjet nga vizitat vlerësuese të EA dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e përbashkët dhe të njëkohshme të gjetjeve;
4. Njohjes së kompetencës teknike të vlerësuesve/ekspertëve teknikë të miratuar nga të dyja palët;
5. Organizimit të krahasimeve ndër-laboratorike të përbashkëta me laboratorët e akredituar të të dyja palëve me qëllim njohjen e performancës së tyre;

Neni 5

Harmonizimi i punës në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarë

Në përputhje me nenin 2, pika 1 (a) të Marrëveshjes, duke pranuar rritjen e nevojës për të ekuilibruar praktikën për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të konsumatorit me mos krijimin e barrierave të panevojshme për biznesin, Palët synojnë unifikimin e praktikave për vlerësimin e sigurisë ushqimore dhe veterinarë, nëpërmjet:

1. Njohjes reciproke të rezultateve të analizave të kryera nga ISUV dhe laboratorit homolog në Kosovë, vetëm për produktet origjinuese në vendet respektive dhe të destinuara vetëm për tregun e Shqipërisë dhe të Kosovës;
2. Hartimit të planit të ndryshimeve legjislative për harmonizimin e legjislacionit të sigurisë ushqimore dhe veterinarë, brenda datës 15 dhjetor 2015;

Neni 6

Zbatimi i Protokollit

1. Parashikimet e nenit 1 dhe nenit 2 të këtij Protokolli do të zbatohen nga Grupi i Punës për barrierat jo-tarifore dhe rregullat teknike në tregti.
2. Parashikimet e nenit 4 të këtij Protokolli do të zbatohen nga Grupi i Punës për barrierat jo-tarifore dhe rregullat teknike në tregti, i cili brenda datës 30 korrik 2015 do të hartojë planin e aktiviteteve për zbatimin e këtij neni.
3. Parashikimet e nenit 5 të këtij Protokolli do të zbatohen nga Grupi i Punës për masat sanitare dhe fito-sanitare.

Neni 7 Ndryshimet

Protokolli mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Protokolli do të lidhet për një periudhë kohore të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Secila Palë, mund të njoftojë palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e Memorandumit të Mirëkuptimit. Përfundimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Bërë në _____, më _____ 2015 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të gjithë tekstet janë njëllë të vlefshëm. Në rast të ndonjë mospërputhje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

GRUPI I PUNËS PËR BARRIERAT JO-TARIFORE DHE RREGULLAT TEKNIKE NË TREGTI

1. QËLLIMI

Identifikimi, rishikimi si dhe propozimi i masave për eliminimin e pengesave të panevojshme në tregti si dhe harmonizimi i legjislacionit primar dhe sekondar (Ligjeve, Udhëzimeve administrative, rregulloreve teknike) me objektiv lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë dypalëshe dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve tona.

Puna e këtij grupi udhëhiqet nga parimet dhe rregullat e OBT, legjislacioni i Bashkimit Evropian në këtë fushë, parimet dhe rregullat e marrëveshjes së tregtisë së lirë "CEFTA 2006" si dhe përcaktimet e marrëveshjes dypalëshe.

2. DREJTIMI

Grupi i Punës drejtohet nga 2 bashkëkryetarë, nga Ministrinë përgjegjëse për tregtinë. Përgjegjësitë e bashkëkryetarëve përfshijnë:

- Përcaktimin e takimeve dhe njoftimin e anëtarëve.
- Drejtimin e takimeve dhe të aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e këtij Grupi Pune.
- Propozimin e vendimeve të përbashkëta për çështjet që janë diskutuar.
- Autorizimin dhe udhëzimin e anëtarëve nga vendet e tyre prej institucioneve përgjegjëse me qëllim të kryerjes së detyrave të caktuara brenda fushës së përgjegjësive të tyre.
- Rishikimin dhe miratimin e minutave të takimit.

Të dy bashkëkryetarët kanë të drejtë të ftojnë specialist të jashtëm të fushës në varësi të çështjeve që diskutohen.

3. ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS

Anëtarët e Grupit të Punës janë përfaqësues nga institucionet përgjegjëse të dy vendeve që mbulojnë fushat e mëposhtme:

- Standardizimi
- Metrologjia
- Akreditimi
- Harmonizimi i rregullave teknike dhe vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut

4. MINUTAT TAKIMIT

Minutat e takimit do të mbahen dhe do të shpërndahen nga një sekretari/person i caktuar nga kryetarët e këtij grupi të punës, përfaqësues i vendit ku mbahet takimi.

5. TAKIMET

Grupi i Punës mbledhet 2 herë në vit dhe çdo herë tjetër që kërkohet për çështje të veçanta.

6. FUNKSIONET

Funksionet e Grupit të Punës mbështeten në përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë në mes të dy shteteve.

Funksionet specifike të grupit të punës janë:

- Harmonizimi i legjislacionit të infrastrukturës së cilësisë të dy shteteve me atë të BE-së,
- Shqyrtimi i analizave sektoriale për të siguruar harmonizimin e legjislacionit në sektorë prioritarë
- Njoftimi paraprak i të gjitha ndryshimeve ligjore që lidhen me barrierat jo-tarifore dhe barrierat teknike.
- Vlerësimi i hapësirave për pranimin i certifikatës së konformitetit lëshuar nga laboratorët e akredituar nga të dy vendet.

GRUPI I PUNËS PËR MASAT SANITARE FITO-SANITARE

1. QËLLIMI

Krijimi i lehtësimit të tregtisë për produktet bujqësore brenda dy shteteve, duke siguruar mbrojtjen e shëndetit të bimëve, kafshëve, sigurinë e ushqimit dhe masat e tjera të aplikuara në tregtinë bujqësore që nuk kufizojnë tregtinë në mënyrë të pajustificueshme. Ky grup pune do të veprojë si një forum për një shkëmbim të rregullt të informacioneve për të identifikuar problemet e përbashkëta dhe për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për të mos rënë ndesh legjislacioni i të dy vendeve, atëherë kur është e mundur nga pikëpamja teknike. Puna e këtij grupi udhëhiqet nga parimet dhe rregullat e OBT-se, parimet dhe rregullat e marrëveshjes së tregtisë së lirë "CEFTA 2006", legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë si dhe përcaktimet e marrëveshjes dypalëshe.

2. DREJTIMI

Grupi i Punës drejtohet nga 2 bashkëkryetarë, nga Ministritë përgjegjëse për bujqësinë. Përgjegjësitë e bashkëkryetarëve përfshijnë:

- Përcaktimin e takimeve dhe njoftimin e anëtarëve.
- Drejtimin e takimeve dhe të aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e këtij Grupi Pune
- Propozimin e vendimeve të përbashkëta për çështjet që janë diskutuar.
- Autorizimin dhe udhëzimin e anëtarëve nga vendet e tyre nga institucionet përgjegjëse me qëllim kryerjen e detyrave të caktuara brenda fushës së përgjegjësisë të tyre.
- Rishikimin dhe miratimin e minutave të takimit.

Të dy bashkëkryetarët kanë të drejtë të ftojnë specialistë të jashtëm të fushës në varësi të çështjeve që diskutohen.

3. ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS

Anëtarët e Grupit të Punës janë përfaqësues nga institucionet përgjegjëse të dy vendeve që mbulojnë fushat e mëposhtme:

- Sigurinë ushqimore,
- Veterinarinë dhe kujdesin e kafshëve,
- Mbrojtjen e bimëve

4. MINUTAT TAKIMIT

Minutat e takimit do të mbahen dhe do të shpërndahen nga një sekretari/person i caktuar nga kryetarët e këtij grupi të punës, përfaqësues i vendit ku mbahet takimi.

5. TAKIMET

Grupi i Punës për masat sanitare fitosanitare mbledhet 2 herë në vit dhe çdo herë tjetër që kërkohet sipas nevojës.

6. FUNKSIONET

Funksionet e Grupit të Punës mbështeten në përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë në mes të dy shteteve.

Funkcionet specifike të grupit të punës janë:

- Organizimi i takimeve të këtij Grupi Pune bazuar në kërkesat e njërës nga palët.
- Harmonizimi gradual i legjislacionit dhe standardeve në fushën e sigurisë së produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, shëndetit të bimëve dhe kafshëve me interes të ndërsjellë.
- Harmonizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave të tranzitit.
- Përshpejtimin e masave të organeve akredituese të dy vendeve për nënshkrimin e Marrëveshjes shumëpalëshe me Organizatën Evropiane të Akreditimit, në fushën e laboratorëve testues dhe në gjithë fushat e tjera
- Palët do të ndërmarrin hapa për të siguruar këmbimin e informacionit të standardizuar për produktet jo-ushqimore që paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve/ përdoruesve, harmonizimin e metodologjive për vlerësimin e riskut dhe komunikimin e tij.
- Nga takimet do të mbahen procesverbalet e mbledhjeve të cilat duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe shpërndahen tek të gjithë anëtarët e grupit të punës për Bujqësinë dhe Masat Sanitare dhe Fito-Sanitare

GRUPI I PUNËS PËR BARRIERAT ADMINISTRATIVE DHE DOGANORE

1. QËLLIMI

Identifikimi, rishikimi, thjeshtëzimi, harmonizimi si dhe propozimi i masave për eliminimin e barrierave të panevojshme administrative dhe doganore në tregti si dhe vlerësimi i kapaciteteve për kontrole të përbashkëta në pikën kufitare të Morinës/Vermicës si edhe përmirësimet të shkëmbimit të të dhënave/informacionit ndërmjet administratave doganore me objektiv lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë dypalëshe dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve tona.

Puna e këtij grupi udhëhiqet nga parimet dhe rregullat e OBT, legjislacioni i Bashkimit Evropian në këtë fushë, parimet dhe rregullat e marrëveshjes së tregtisë së lirë "CEFTA 2006" si dhe përcaktimet e marrëveshjes dypalëshe për lehtësimin e tregtisë.

2. DREJTIMI

Grupi i Punës drejtohet nga 2 bashkëkryetarë, nga Drejtoritë e Përgjithshme të Doganave të të dyja vendeve. Përgjegjësitë e bashkëkryetarëve përfshijnë:

- Përcaktimin e takimeve dhe njoftimin e anëtarëve.
- Drejtimin e takimeve dhe të aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e këtij Grupi Pune.
- Propozimet për Ministrat përgjegjës për tregtinë nga vendimet e përbashkëta për çështjet që janë diskutuar.
- Autorizimin dhe udhëzimin e anëtarëve nga vendet e tyre prej institucioneve përgjegjëse me qëllim të kryerjes së detyrave të caktuara brenda fushës së përgjegjësive të tyre.
- Të dy bashkëkryetarët kanë të drejtë të thërrasin specialistë të jashtëm të fushës në varësi të çështjeve që diskutohen.
- Rishikimin dhe miratimin e minutave të takimit.

3. ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS

Anëtarët e Grupit të Punës janë përfaqësues nga administratat doganore të të dy vendeve.

4. MINUTAT TAKIMIT

Minutat e takimit do të mbahen dhe do të shpërndahen nga një sekretari/person i caktuar nga kryetarët e këtij grupi të punës, përfaqësues i vendit ku mbahet takimi.

5. TAKIMET

Grupi i Punës mbledhet 2 herë në vit dhe çdo herë tjetër që kërkohet për çështje të veçanta.

6. FUNKSIONET

Funksionet e Grupit të Punës mbështeten në përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë në mes të dy shteteve.

Funksionet specifike të grupit të punës janë:

- Thjeshtimi dhe harmonizimi i proceseve dhe procedurave të zhdoganimit të mallrave,
- Vlerësimi i mundësive për futjen e skemave efektive të garancisë për tranzitin,
- Përmirësimi i shkëmbimit të të dhënave / informacionit ndërmjet agjencive doganore ,


- Sigurimi i lidhjes efektive dhe ndërveprimin e sistemeve doganore elektronike të përdorura në Shqipëri dhe Kosovë,
- Harmonizimi i standardeve dhe kërkesave për agjentët e transportit të mallrave dhe të shërbimeve të agjentëve doganorë.

NR.PROT.1349/1
DATË 19.3.2015

MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'DREJTORIA E PËRGJITHSHME' and 'MINISTERIA E'.